

# Oh sa mirë, që ti je këtu!

Një libër prezantues mbi ndihmën e Kinder- und  
Jugendhilfe për fëmijët dhe prindërit refugjatë

ALBANISCH

Luisa Gebauer

Anna Laura Jacobi





Familja e Jusefit u detyrua të braktisë shtëpinë dhe më pas edhe atdheun. Babi pati thënë: „Këtu është bërë shumë e rrezikshme për ne. Ne duhet të largohemi.“  
Ata kanë udhëtuar larg. Ndonjëherë ata ishin të detyruar të përshkojnë rrugë gjata në këmbë. Një herë, ata kanë qenë me shumë njerëz të tjerë për orë të tëra në një kamion që hidhej herë pas here përpjetë. Kishte shumë njerëz. Për këtë arsye, ambienti ishte tepër i ngushtë dhe ajri shumë i rëndë. Jusefi ishte shumë frikësuar. Ndonjëherë nuk kishin mjaftueshëm për të ngrënë dhe ndonjëherë flinin në vende, të cilat ishin të ftohta dhe të frikshme. Kur Jusefit i kalon nëpër mend udhëtimi i gjatë, ai përjeton atë ndjesinë e çuditshme në bark. Tani familja e Jusefit jeton në Gjermani, në një strehë për njerëzit e arratisur.



Jusefi, mami, babi dhe binjakët Mo dhe Bo banojnë në një dhomë të vogël. Në këtë strehim jetojnë shumë njerëz. Ata banojnë, flenë dhe hanë në një ambient të ngushtë. Shpesh ndodhin grindje. Madje edhe të rriturit grinden, ndo njëherë edhe natën – atëherë askush nuk mundet të vë gjumë në sy.



Çdo gjë këtu është ndryshe nga vendlindja: moti, gjuha dhe mbi të gjitha ushqimi. Në strehim ka gjithmonë të njëjtat gjëra për të gjithë. Jusefit nuk i shijon ushqimi këtu. Atij i mungojnë gjellët, të cilat mami gatuate më parë për ta.

Vëllai i vogël i Jusefit, Mo qan gjatë gjithë kohës. Dhe kur Mo qan, qan edhe Bo. Ndoshta edhe binjakëve nuk u pëlqen këtu, mendon Jusefi. Ka ditë, në të cilat ata qajnë me zë aq të lartë, sa që edhe mami fillon e qan bashkë me ta. Atëherë babi nuk pipëtin fare dhe Jusefi ka përsëri atë ndjesinë e keqe në bark.



Por më e keqja për Jusefin është mërzia e kotësisë. Vetëm ndonjëherë vjen mësuesi për të ushtruar gjermanisht me fëmijët në strehim. Ndërkohë, që çdo fëmijë ka të drejtë të shkojë në shkollë! Këtë gjë Jusefi e di dhe atij i mungon shkolla. Ai dëshiron të mësojë dhe të luajë futboll me fëmijët e tjerë gjatë pushimit në oborrin e shkollës. Por në Gjermani duhet të presësh për çdo gjë. Të rriturit presin vazhdimisht për letra dhe për takime. Jusefi pret për shkollën. Por askush nuk mund të thotë, se sa do të zgjasë kjo pritje e mërzitshme.





Në këtë strehim banon edhe Aisatu me nënën e saj dhe motrën e saj të vogël, Binta. Nganjëherë Jusefi shkon tek ajo, për të luajtur me zara.

Edhe sot Jusefi po troket te dera e saj. Aisatu e hap dhe e përshëndet: „Ç’kemi, Jusef.“ Por më pas ajo i thotë: „Sot nuk kam kohë të luaj zarash me ty. Ne po shkojmë te qendra e familjes.“ Ajo buzëqesh, sepse është e gëzuar që po shkon atje.

„Për çfarë?“, pyete Jusefi.

„Tek qendra e familjes“, sqaron Aisatu.

„Sot pasdite mbledhet atje klubi i fëmijëve. Atje mund të luash dhe të bësh punë me dorë. Aty ka edhe një kopsht, me një pemë shumë të bukur për tu kacavjerrë dhe me një rrëshqitëse. Dëshiron të vish bashkë me mua?“ pyet ajo.

Jusefi është shumë i emocionuar. Po, ai dëshiron të shkojë me patjetër. Kështu Aisatu dhe Jusefi shkojnë te prindërit e tij, për të marrë leje. Mami i Aisatut dhe Bintës i shoqërojnë ata.







Binjakët janë duke qarë përsëri me zë të lartë. Mami dhe babi as që nuk dëgjojnë se çfarë thotë Jusefi. Kur ai më në fund arrin të shpjegojë, që dëshiron të shkojë bashkë me Aisatun te qendra e familjes, babi tund kokën.

„Jo, Jusef, më mirë jo.“

Jusefi pothuajse e parandiente, që për babin kjo nuk ishte një ide e mirë. Që kur kanë ardhur në Gjermani, babi është bërë tepër i kujdesshëm. Me siguri, sepse edhe për atë këtu është gjithçka e re dhe e huaj, mendon Jusefi.

„Atje ka edhe shumë fëmijë të tjerë dhe aty është edhe zonja Schmidt“, thotë Aisatu. „Ajo është shumë e sjellshme dhe luan me ne. Të lutem, a mund të vijë edhe Jusefi me mua? Ne do kujdesemi për të.“

„Jo, më mirë jo“, përgjigjet babi.

„Atje ka edhe një kafe për prindërit dhe një grup për fëmijët e vegjël që lëvizin ende këmbadoras. Me siguri që binjakëve do t’u pëlqente shumë“, shpjegon mami i Aisatut. „Ejani edhe ju me ne.“

„Jo, më mirë jo“, përgjigjet babi.

Mami mendohet. „Kjo tingëllon bukur, le të shkojmë e ta shohim njëherë.“

„Hm, nuk e di“, mëmërit babi.

„Unë mendoj, që ne duhet të shkojmë të gjithë së bashku atje“, thotë mami me guxim.





Dhe kështu, ata të gjithë së bashku marrin rrugën për te qendra e familjes.




„Përshëndetje Aisatu, kë na paske sjellë me vete kështu?“, e përshëndet atë një zonjë në hyrje.

„Përshëndetje zonja Schmidt, ky është Jusefi. Ai dëshiron të njihet me klubin e fëmijëve.“

„Mirë se erdhe Jusef. Gëzohem që ke ardhur!“, thotë zonja Schmidt.

„Siç po e shoh, ti ke sjellë me vete edhe mamin, babin dhe vëllezërit e tu.

Unë jam zonja Schmidt. Dëshironi t'ju tregoj qendrën tonë të familjes?“







„Qendra e familjes është një vend për fëmijët dhe prindërit“, shpjegon zonja Schmidt. „Këtu punojnë njerëz, të cilët marrin vesh nga edukimi, psikologjia dhe puna sociale, kështu si unë. Ky është profesioni ynë. Ne luajmë dhe bëjmë gjimnastikë me fëmijët dhe të rinjtë. Ne dëgjojmë me vëmendje dhe japim këshilla, nëse dikush ka shqetësime. Ndonjëherë ne ndihmojmë edhe me detyrat e shtëpisë ose gatujmë dhe pjekim së bashku. Ne jemi pjesë e sistemit për mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve Kinder- und Jugendhilfe në Gjermani.“

„Atëherë ky është një vend për familjet, të cilat kanë nevojë për ndihmë?“, pyet babai.

„Jo, ky është një vend për **të gjithë** fëmijët dhe prindërit. Natyrisht edhe për familjet, të cilat kërkojnë ndihmë“, shpjegon zonja Schmidt.

„Por shumica e njerëzve vijnë për shkak të mundësive të shkëlqyera që ne ofrojmë për fëmijët dhe të rinjtë. Ofertat janë falas.“

„Atëherë kjo është një shtëpi për njerëzit e varfër?“, dëshiron të dijë babi.

„Jo, kjo është një shtëpi për të gjithë“, thotë zonja Schmidt. „Në Gjermani, në shumicën e qyteteve dhe komunave ka shtëpi si kjo. Qëllimi i Kinder- und Jugendhilfe është të ndihmojë, që fëmijët dhe të rinjtë të jenë mirë dhe që ata të mund të rriten të shëndetshëm. Të gjitha familjet – nuk ka rëndësi nëse janë të pasura ose të varfra – mund t'i përdorin mundësitë që ajo ofron. Disa nga këto mundësi ofrohen këtu, në qendrën e familjes ...“





„Klubi i fëmijëve takohet sot në kopsht“, shpjegon zonja Schmidt.

„Në vendlindjen time nuk ka pasur klub për fëmijët“, thotë Jusefi. „Unë kam luajtur gjithmonë me kushërinjtë e mi. Edhe hallat dhe tezet e mija dhe gjyshërit e mi ishin aty.“

„Në Gjermani ka shumë fëmijë, kushërinjtë, hallat, tezet, xhaxhallarët, dajat dhe gjyshërit e të cilëve jetojnë shumë larg. Në mënyrë që ata të mos jenë të detyruar të luajnë vetëm, ekzistojnë mundësi të hapura si klubi ynë i fëmijëve. Fëmijët deri në gjashtë vjeç shkojnë në kopsht, dhe për fëmijët e shkollës ka një qendër kujdesi pas mësimi. Këtu nevojitet vetëm të regjistrohesh“, shpjegon zonja Schmidt.

„Kjo është qendra jonë e edukimit dhe e këshillimit të familjes. Kur mamin ose babin i shqetëson diçka, ajo ose ai mund të vijnë këtu për t’u këshilluar“, thotë zonja Schmidt.

„Më përpara unë flisja gjithmonë me vjehrrën time mbi edukimin“, tregon mami i Jusefit.

„Këtu janë persona me përvojë , të cilët i dëgjojnë prindërit me vëmendje, dhe në rast problemesh ata kërkojnë së bashku një zgjidhje“, thotë zonja Schmidt. „Kushdo mund të caktojë një takim. Natyrisht që bisedat janë konfidenciale dhe falas. Madje as emrin nuk janë të detyruar ta thonë.“






„Këtu shihni grupin e fëmijëve këmbadoras“, thotë zonja Schmidt. „Këtu takohen prindërit, bebet dhe fëmijët e vegjël. Për këtë grup kujdeset kolegja im. Ajo u jep nënave dhe baballarëve këshilla, se si të luajnë me bebet e tyre, se si t'i nxisin ato dhe të kujdesen për to.“



„Këtu, në kafe mamatë dhe baballarët mund të pinë një kafe ose çaj dhe të njihen me prindër të tjerë. Me raste, këtu zhvillohen mbërëmje informuese mbi tematikat e familjes dhe edukimit. Përveç të tjerave, ëmbëlsira e zonjës Öztürk është shumë e shijshme.“

„Përshëndetje!“, thotë zonja Öztürk. „Ju mund të vini edhe tek unë, nëse ju nevojitet diçka nga dhoma jonë e veshmbathjeve. Aty ne kemi rroba dhe lodra për fëmijë.“








„Das Jugendamt?“, thërret babi i tmerruar. „Unë kam dëgjuar tashmë shumë histori për këtë Jugendamt! Ato përzihen në edukimin e fëmijëve dhe marrin fëmijët nga familjet e tyre!“, ankohe babi.

„Jo, askush nuk lejohet që thjeshtë të marrë një fëmijë nga familja e tij“, shpjegon zonja Schmidt. „Fëmijët kanë të drejtën të kenë prindërit e tyre dhe prindërit kanë të drejtën që ti edukojnë dhe të kujdesen për fëmijët e tyre. Kjo gjë është e shkruar në kushtetutë, ligjin më të rëndësishëm gjerman. Por, ndonjëherë mund të krijohet një rrezik serioz për një fëmijë. Ndonjëherë prindërit nuk mund ta mbrojnë dot vet fëmijën e tyre, dhe ndonjëherë as Jugendamt nuk është në gjendje të ndihmojë. Vetëm atëherë merret në konsideratë një masë e tillë. Një gjë e tillë nuk vendoset kurrë lehtësisht. Një vendim i tillë duhet të verifikohet dhe të miratohet nga një gjykatë. Por, në shumicën

e rasteve Jugendamt mund t’ju vijë më parë në ndihmë prindërve, nëse fëmija është në rrezik“, shpjegon zonja Schmidt. „Atëherë një vendim i tillë nuk është më fare i nevojshëm. Jugendamt është aty, për ti mbështetur familjet – edhe në rrezik.“

„Hm, nuk e di“, hundo babi mosbesues.

„Kjo këtu është një ofertë për të rinjtë. Këtu ata marrin mbështetjen e duhur për pyetjet dhe temat, të cilat janë të rëndësishme për ta. Për shembull, nëse bëhet fjalë për ndjenja si zemërimi, inati apo frika, apo pyetjet në lidhje me çështjet e rritjes. Kjo ofertë quhet „Puna sociale në grup“. Në këtë mënyrë Jugendamt dëshiron të ndihmojë të rinjtë në situata të vështira“, shpjegon zonja Schmidt.






„A mund të shkojmë të luajmë tani?“, pyet Aisatu me padurim. „Unë dëshiroj t'i tregoj Jusefit pemën ku kacavirremi!“

Babi vazhdon të shohë me mosbesim. Tani shohin të gjithë të tensionuar. „Mhm“, mëmërit ai. „Epo mirë. Por bëni kujdes kur të kacavirreni“, mëmërit ai.

„Juhu!“ gërthet Jusefi nga gëzimi. Aisatu e merr atë për dore, dhe ato vrapojnë për në kopsht.







Pema e kacavarjes është super. Jusefi arrin madje deri te kurora e pemës. Nga këtu ai mund të shohë mamin dhe binjakët. Ai sheh edhe babin. Ai është ulur te kafja dhe po ha një copë ëmbëlsirë. Po buzëqesh ai vallë?

„Zbrit përsëri poshtë, Jusef. Ne duam të luajmë futboll!“, thërret Aisatu nga poshtë.

Dhe kështu ata kalojnë një ditë të mrekullueshme në qendrën e familjes.





Që prej kësaj dite të mrekullueshme, Jusefi, mami, babi dhe binjakët vijnë shpesh te qendra e familjes.

Këshilltarët e edukimit dhe familjes i kanë dhënë mami dhe babin këshilla, se si ata të mund t'i ndihmojnë binjakët që të qetësohen. Me sukses! Mo dhe Bo nuk qajnë më aq shumë dhe mami nuk qan më fare.

Babi nuk është më mosbesues dhe i heshtur. Madje, një herë ai ka folur me një punonjës social të Jugendamt. Ai do ta ndihmojë për të gjetur vende në çerdhe për Mo-në dhe Bo-në. Ai i ka shpjeguar edhe, se si familja mund të kërkojë mbështetje për gjetjen e një banese, sapo ajo të ketë mundësinë të largohet nga strehimi.

Por gjëja më e mirë është, që Jusefit nuk i duhet të mërzitet më kaq shpesh. Në klubin e fëmijëve ai dhe Aisatu kanë gjetur shokë, me të cilët luhet super futboll. Dhe atë ndjesinë e keqe në bark, Jusef nuk e ka më aq shpesh.





Të dashur prindër,

Jusefi dhe familja e tij sapo kanë ardhur në Gjermani dhe tani po njihen me **Kinder- und Jugendhilfe [Ndihma për fëmijët dhe të rinjtë]**. Kinder- und Jugendhilfe është pjesë e sistemit social gjerman. Ajo j`u drejtohet të gjitha familjeve - pavarësisht nga prejardhja ose gjuha e tyre. Detyra e saj është, të ndihmojë që, fëmijët dhe të rinjtë të ndjehen mirë dhe të mund të rriten të shëndetshëm. Kopshti ditorë i fëmijëve (Kita) është shërbimi më i njohur, të cilin e marrin pothuajse të gjithë fëmijët në Gjermani. Por ka edhe shumë gjëra të tjera, siç po mësojnë Jusefi dhe familja e tij. Ky libër ka për qëllim të informojë mbi këtë fakt dhe t`ju nxisë juve, që të zbuloni ofertat e Kinder- und Jugendhilfe për ju vetë.

Ne ju urojmë të argëtoheni gjatë leximit ose dëgjimit të këtij libri!



© 2011, 2012, 2013

**Shërbime dhe terma të rëndësishëm të Kinder- und Jugendhilfe:**

**© 2011, 2012, 2013**

**Jugendamt**

Çdo qytet dhe çdo qark (Landi) ka një **Jugendamt**. Enti i Jugendamt ka shumë detyra të ndryshme: Ato kujdesen që qyteti i tyre të jetë i këndshëm për fëmijët dhe familjet. Për shembull, kjo do të thotë, që të ketë mjaftueshëm sheshe lodrash dhe që politika të marrë vendime të mira për familjet. Enti Jugendamt kujdeset që institucionet Kinder- und Jugendhilfe të bëjnë punë të mirë. Në zyrat e Jugendamt punojnë punonjës socialë. Detyra e tyre është që të mbështesin fëmijët, të rinjtë dhe prindërit, të cilën dëshirojnë të kenë këshillim ose ndihmë. Dhe nëse një fëmijë është në rrezik, ato punojnë bashkë me prindërit për një përmirësim të situatës dhe mbrojnë fëmijën.

**Kopshtet ditorë dhe çerdhet e fëmijëve (Kitas)** janë

institucione arsimore dhe kujdesi, të cilat frekuentohen nga fëmijët deri në hyrjen e tyre në shkollë. Në kopsht, fëmijët bashkohen me bashkëmoshatarët, ata nxiten dhe mbështeten nga pedagogë për t`u zhvilluar në një mjedis me shumë nxitje në përputhje me interesat a tyre. Frekuentimi i kopshtit ditor është i rëndësishëm për të gjithë fëmijët. Fëmijët, të cilët mësojnë gjermanisht si gjuhë të dytë, përfitojnë shumë nga hyrja e hershme. Çdo fëmijë në Gjermani, duke filluar nga një vjeç ka të drejtën e një vendi në një kopsht ditor. Në disa qytete nuk ka vende të mjaftueshme për të gjithë fëmijët, atëherë kujdesi ditor për fëmijët mund të jetë një alternativë. Në këtë rast, një edukatore ditorë ose një edukator ditor kujdeset për deri në pesë fëmijë. Zyrat e Jugendamt ofrojnë ndihmë për gjetjen e një vendi kujdesi për fëmijët.

**(Schul-/Kinder-)Horte Qendrat e kujdesit pas-shkollorë janë** mundësi kujdesi për fëmijët deri në 14 vjeç që shkojnë në shkollë. Fëmijët hanë aty drekën dhe marrin ndihmë me detyrat e shtëpisë, ata marrin pjesë te aktivitetet në kohën e lirë dhe trajtohen nga ana pedagogjike. Shpesh shkollat kanë vetë një qendër ditorë. Edhe gjatë kërkimit për një vend në qendrën ditorë mund të vijë në ndihmë Jugendamt.

**Qendrat e familjes** janë institucione, te të cilat ofrohen shumë shërbime të Kinder- und Jugendhilfe. Ato mund të jenë një ndihmë e mirë orientuese, për t`u integruar në një qytet ose lagje të re.

**Institucionet e edukimit familjar** ofrojnë kurse në sektorët e jetës familjare, shëndetit dhe kohës së lirë. Për të rriturit ka oferta në lidhje me temat si partneriteti dhe edukimi. Nganjëherë ka edhe mundësi të tjera, për shembull kurse për gjermanishte ose qepje. Shumë kurse u drejtohen prindërve dhe fëmijëve së bashku, për shembull masazh për bebet, ndërsa pas lindjes edhe kurse për prind-fëmijë. Për fëmijët ka shpesh oferta si edukimi i hershëm muzikor, punë me dorë ose lëvizje.

Tek **ofertat e hapura Kinder- und Jugendhilfe** mund të merrni pjesë pa u regjistruar më parë dhe falas. Kështu për shembull ekzistojnë klubet për fëmijët dhe për të rinjtë, këndet rekreative të lojërave me përkujdesje sociale dhe pedagogjike, takime të prindërve ose grupet e lëvizjes këmbadoras për fëmijë të vegjël dhe prindërit e tyre. Shumë qendra të kujdesit publik (qendrat për të rinjtë, familjet, lagjet ose qytetit) ofrojnë mundësi të hapura.

**Ofertat për kalimin e kohës së lirë dhe të pushimeve** u ofrojnë fëmijëve dhe të rinjve, në kohën e lirë mundësi të mrekullueshme, që ta kalojnë kohë në mënyrë krijuese, sportive dhe kulturore me bashkëmoshatarët e tyre. Gjatë kësaj kohe ekziston një kujdes pedagogjik në funksion të tyre. Mundësitë ofrohen nga qendrat e Kinder- und Jugendhilfe. Zyrat e Jugendamt mund të ndihmojnë, për të gjetur mundësinë e duhur për pushimet. Nëse është e nevojshme, ekzistojnë edhe mundësi për mbështetjen financiare.

**Ndihma për edukimin** mbështet familjet me sfida të veçanta, në mënyrë që fëmijët të jenë mirë, edhe pse situatat janë të vështira, dhe që ata të mund të rriten të shëndetshëm.

Edhe përvojat e arratisjes, ardhjes në një shoqëri të re dhe kufizimet e sistemit të azilit të dhe të pritjes mund të paraqesin ngarkesë të madhe për familjet.

Për shembull, ndihmat për edukimin janë:

· Një **këshillim për edukimin dhe familjen** mund të përdoret nga të gjithë prindërit – nëse dëshirohet edhe anonim – Qendrat e këshillimit për edukimin dhe familjen i gjeni pranë Jugendamt, në qendrat e familjes dhe të qytetit. Përveç pyetjeve mbi edukimin dhe jetën familjare, prindërit këtu mund të flasin edhe mbi tema që kanë të bëjnë me martesën ose partneritetin.

· Një **ndihmës social-pedagogjik për familjet (SPFH)** është një person i specializuar, i cili e viziton rregullisht familjen, për të mbështetur prindërit në çështje të caktuara.

· Një **asistencë edukimi** / një **ndihmës kujdesi** punon rregullisht me fëmijën ose me të riun dhe ofron mbështetje në çështjet e zhvillimit personal, nëse ka vështirësi në jetën e përditshme, në shkollë apo në shtëpi.

Një SPFH ose një asistencë për edukimin ngarkohen me detyrë nga Jugendamt. Prindërit mund t`i drejtohen Jugendamt, nëse ata dëshirojnë të kërkojnë një mbështetje të tillë. Ndonjëherë, nëse Jugendamt, ka arsyet për të supozuar që është e nevojshme një ndihmë, ajo i drejtohet vetë familjes dhe vendos bashkë me të, nëse duhen dhe çfarë ndihmash janë të përshtatshme.



### Shërbime të tjera për mirëqenien e fëmijëve dhe familjes:

Për **shtatzënat, foshnjat, fëmijët e vegjël deri** në tre vjeç dhe prindërit e tyre ka gjithashtu mundësi të dobishme në sektorin shëndetësor: Kurse parapërgatitore për lindjen dhe kurse pas lindjes për gratë, kurse prindërore për nënat dhe baballarët e rinj dhe mundësi këshillimi për sa i përket kujdesit dhe nxitjes së foshnjave dhe fëmijëve të vegjël. Mami(për familjen), shërbime sociale në spitale, institucione për edukimin e familjes dhe qendra këshillimi pranë zyrave të Jugendamt janë pikat e kontaktit për ndihmën e hershme.

**Informacione të dobishme:** Në Gjermani ekzistojnë **ekzaminime të zbulimit të hershëm** për fëmijët deri në 6-të vjeç. Këto ekzaminime (U1-U9) kryhen nga mjekët pediatër dhe kontrollojnë përveç shëndetit të fëmijës edhe nivelin e zhvillimit të tij mendor dhe motorik. Ai është i rëndësishëm për të dalluar shpejt, nëse një fëmijë ka nevojë për nxitje të veçantë. Në shumë Lande Federale prindërit marrin ftesa. Por ju mund të informoheni edhe te mjeku pediatër ose te mamia juaj. Pas përfundimit të U1 deri U9 pasojnë U10 dhe U11 si dhe ekzaminimet e shëndetit për të rinjtë J1 dhe J2. Një „fletore e verdhë“ dokumenton ekzaminimet U.

Botuesit falënderojnë përzemërsisht zotin Stefan Zavar-Schlegel, drejtuesin e shërbimit të përgjithshëm social të qytetit të Trier, dhe zonjën Dr. Johanna Graf, psikoterapiste psikologe për fëmijë, të rinj dhe të rritur për këshillimin konceptual dhe profesional.

Ky libër me fotografi dhe tekst është botuar në gjuhët shqip, arabisht, dari, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, rusisht, somalisht, tigrinja dhe turqisht.

### IMPRESSUM

**Botuesi** Save the Children Deutschland e.V.  
Seesener Straße 10-13  
10709 Berlin

Plan International Deutschland e.V.  
Bramfelder Str. 70  
22305 Hamburg

**Konceptuan dhe bashkëvepruan** Luisa Gebauer  
Dr. Johanna Graf  
Dr. Stefanie Röhrs  
Janneke Stein  
Eli Myriam Tchouadje

**Teksti** Luisa Gebauer

**Ilustrimi dhe layout** Anna Laura Jacobi

**Korrigjoi** Angelika Lauriel

**Përktheu** Dialecta Zentrum für Internationale Sprachdienstleistungen GmbH

**Printoi** dieUmweltDruckerei GmbH

Copyright © Save the Children Deutschland e.V. dhe Plan International Deutschland e.V., Berlin dhe Hamburg 2022

Hartimi i këtij libri me fotografi dhe tekst u mbështet nga Ministria Federale për Familjen, të Moshuarit, Gratë dhe të Rinjtë në kuadrin e projektit „Së bashku për më shumë përfshirje të fëmijëve dhe familjeve refugjate në sistemin e Kinder- und Jugendhilfe. Krijimi i qasjeve – Nxitja e bashkëpunimeve!“. Ky botim nuk paraqet një opinion të Ministrisë Federale për Familjen, të Moshuarit, Gratë dhe të Rinjtë.





Jusefi jeton me mamin, babin dhe binjakët më të vegjël Mo dhe Bo në një strehë për njerëzit e arratisur. Atij nuk i pëlqen këtu. Familja ndan një dhomë të vogël, dhe kurrë nuk janë vetëm, shpesh ka grindje dhe për fëmijët këtu nuk ka asgjë për të bërë. Shpesh Jusefi mërzhitet. Edhe binjakëve nuk u pëlqen këtu, ato qajnë pa pushim. Mami dhe babi nuk e dinë, se si mund ta përmirësojnë situatën. Përmes shoqes së tij, Aisatu, Jusefi njihet me Kinder- und Jugendhilfe. Shpejt ai gjen shokë të rinj në klubin e fëmijëve, dhe mami dhe babi mësojnë aty se si shërbimet që ofrohen nga Kinder- und Jugendhilfe mbështesin dhe ndihmojnë familjet e sapoardhura për t'u ambientuar me Gjermaninë dhe për t'u përballur me sfida të tjera.

**Një libër prezantues mbi mbështetjen që ofron Kinder- und Jugendhilfe për fëmijët dhe prindërit e arratisur**



Gefördert vom:

